




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/31
Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti i mbledhjes së 30 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/31

Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, neneve 8.4, 10, 11, 17 dhe 37 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Pasaportat diplomatike dhe zyrtare lëshohen vetëm nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe përfaqësitë diplomatike dhe konsullore jashtë shtetit.
2. Pasaportat diplomatike dhe zyrtare nënshkruhen nga Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme, apo me autorizim të këtij të fundit nga shefi i misionit të përfaqësisë diplomatike apo konsullore jashtë shtetit.
3. Pasaportat diplomatike dhe zyrtare jepen për të dalë jashtë shtetit personave që bëjnë pjesë në kategoritë në vijim:

3.1. Në mbështetje të nenit 10 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, pasaportat diplomatike u jepen për të dalë jashtë shteti:

- Presidentit të Republikës së Kosovës;
- Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Kryeministrit;
- Zëvendëskryeministrave;
- Ministrave;
- Zëvendësministrave;
- Shefit të Stafit të Zyrës së Kryeministrit
- Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës;
- Avokatit të Popullit;
- Nëpunësve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore si dhe misioneve të Republikës së Kosovës jashtë shtetit, që kanë emërimet diplomatike;

- nëpunësve të Ministrisë së Punëve të Jashtme që kryejnë punë diplomatike dhe konsullore dhe kanë emërimet diplomatike;
- personave që me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës shkojnë për punë në organizatat ndërkombëtare si zyrtarë të rangut diplomatik.
- prijësve të delegacioneve shtetërore të Republikës së Kosovës;

3.3. Pasaporta diplomatike i lëshohet edhe bashkëshortit/es dhe fëmijëve deri në moshën 18 vjeçare, të:

- Kryetarit të Republikës së Kosovës;
- Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Kryeministrit;
- Zëvendëskryeministrave;
- Ministrave

3.4. Pasaporta diplomatike i lëshohet edhe bashkëshortit/es dhe fëmijëve, të cilët jetojnë në bashkësi familjare të zyrtarëve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore të misionëve të Republikës së Kosovës jashtë shtetit, si bashkëshortit/es dhe fëmijëve të personit, që me vendimin e Qeverisë shkojnë për punë në organizatat ndërkombëtare, nëse me ta jetojnë në bashkësi familjare të përbashkët jashtë shtetit.

3.5. Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, pasaporta zyrtare u jepen për të dalë jashtë shtetit vetëm për nevoja të udhëtimit zyrtar personave, që bëjnë pjesë në këtë kategori:

- Sekretarit të Presidencës;
- Sekretarit të Kuvendit;
- Sekretarëve të Përhershëm të Qeverisë;
- Shefave të kabinetit dhe këshilltarëve politik të Presidencës, Kuvendit dhe Qeverisë;
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Kryetarit të asociacionit të Komunave
- Zyrtarëve të lartë, në poste udhëheqëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- Personelit të punësuar në përfaqësitë diplomatike apo konsullore të Republikës së Kosovës jashtë shtetit, që nuk kanë pasaportë diplomatike;
- Anëtarëve të delegacioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.

3.6. Pasaportë zyrtare mund t'i lëshohet edhe bashkëshortit/es dhe fëmijëve, të cilët jetojnë në bashkësi familjare personelit të punësuar të cilët jetojnë në bashkësi familjare në përfaqësitë diplomatike apo konsullore, të cilët nuk kanë pasaportë diplomatike.

4. Pas përfundimit të udhëtimit zyrtar, pasaportat zyrtare duhet të dorëzohen në Zyrën për çështje konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
5. Pasaportat diplomatike, pas përfundimit të mandatit, dhe pasaportat zyrtare, pas përfundimit të udhëtimit zyrtar, depozitohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

6. Në rast se mbajtësi i pasaportës diplomatike apo zyrtare shkarkohet nga detyra, largohet nga puna apo emërohet në një detyrë tjetër, ai është i detyruar të dorëzojë pasaportën diplomatike ose zyrtare.
7. Në rast mosdorëzimi të pasaportës diplomatike ose zyrtare, Drejtoria për Çështje Konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme njofton të gjitha përfaqësitë e huaja të akredituara për pavlefshmërinë e pasaportës së padorëzuar. Drejtoria për Çështje Konsullore, gjithashtu, njofton për këtë rast Ministrinë e Punëve të Brendshme, e cila urdhëron të gjitha pikat e kalimit kufitar për moslejimin e daljes jashtë shtetit të mbajtësit të kësaj pasaporte, si dhe bllokimin e pasaportës.
8. Në rast se mbajtësi i pasaportës diplomatike apo zyrtare e humb atë gjatë kohës që është në shërbim, do të ripajiset me pasaportë të re, vetëm pasi drejtoria e personelit të ministrisë apo institucionit përkatës të ketë dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme kërkesën, deklaratën e personit ku sqaron rrethanat e humbjes, si dhe një vërtetim të marrë nga Ministria e Brendshme ku të jetë konfirmuar se humbja e kësaj pasaporte u është bërë e njohur të gjitha pikave të kalimit kufitar.
9. Pasaporta diplomatike dhe pasaporta zyrtare, lëshohet për kohën e kryerjes së detyrës, por afati i vlefshmërisë së tyre nuk mund të jetë më shumë se 5 vjet.
10. Vetëm Ministria e Punëve të Jashtme mund ta zgjas afatin e vlefshmërisë së pasaportave diplomatike dhe zyrtare. Vendimin për zgjatjen e vlefshmërisë e merr Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme.
11. Lëshimi i pasaportave diplomatike dhe zyrtare ose zgjatja e afatit të vlefshmërisë së tyre bëhet kundrejt pagesës sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Punëve të Jashtme.
12. Për shkeljen e rregullave të këtij vendimi zbatohen sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi.
13. Plotësimi dhe ndryshimi i këtij vendimi mund të bëhet vetëm me vendim të Qeverisë, me propozim të ministrit të Punëve të Jashtme.
14. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/31
Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 25 (njëzetepesë) milion Euro.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të vendimi destinohet për blerjen e ndërtesave-objekteve për përfaqësitë diplomatike dhe konsullore jashtë vendit.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/31
Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Qeveria e Kosovës për anëtarë të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave propozon këta kandidatë:
 - Skender Kolgeci, kryesues
 - Miftar Shala, anëtar
 - Ramadan Sejdiu, anëtar
 - Ekrem Kastrati, anëtar
 - Osman Sadikaj, anëtar
 - Luljeta Baraliu, anëtare
 - Hajrush Beqiri, anëtar
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit, që emrat e kandidatëve së bashku me CV-të e tyre, t'i procedojë për miratim në Kuvendin e Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 05/31

Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenit 9 paragrafi 1 i Ligjit të Buxhetit për vitin 2008, nr. 03/L-088 i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-93 si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007 Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për transferimin e mjeteve financiare nga Programi – Rezerva e Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, në shumë prej 200.000 €, kodi organizativ 232, kodi i programit 131, në Programin – Minierat e Trepçës, kodi organizativ 239, kodi i programit 228 në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/31
Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Republikan i Festave në këtë përbërje:
 - 1) Zyra e Kryeministrit
 - 2) Ministria e Shërbimeve Publike
 - 3) Ministria e Drejtësisë
 - 4) Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 - 5) Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
 - 6) Ministria për Komunitete dhe Kthim
 - 7) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
 - 8) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 - 9) Kuvendi i Kosovë
 - 10) Zyra e Presidentit
2. Komisioni Republikan i Festave do të përgatitë rregullat dhe mënyrat e festimit të festave zyrtare si dhe ditët memoriale dhe më së largu gjer në fundin e muajit tetor të vitit vijues, nxjerr kalendarin e festave zyrtare dhe ditët memoriale, për vitin që vjen, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjitha ministratë të cilat janë përfshira në këtë Komision.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/31

Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për shqyrtimin ofertës së Postë-Telekomunikacionit të Kosovës lidhur me ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile në këtë përbërje:
 - 1) Ministria e Ekonomisë dhe Financave
 - 2) Ministria e Shërbimeve Publike
 - 3) Ministria e Punëve të Jashtme
2. Obligohet Komisioni që në afat 2 (dy) javorë t'i ofroj Qeverisë së Kosovës propozimin konkret lidhur me këtë ofertë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/31
Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për financimin e ndërtimit të rrethojës së Kompleksit Memorial “Zahir Pajaziti” në fshatin Orllan, Komuna e Podujevës.
2. Mjetet financiare në vlerë prej 35,084.20 euro ndahen nga fondi rezervë i Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.
3. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/31
Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë të Bordit të Rregullatorit të Energjisë propozon:
 - a. z.Blerim Koci
 - b. z.Përparim Kabashi
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit, që emrat e kandidatëve së bashku me CV-të e tyre, t'i procedojë për miratim në Kuvendin e Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/31
Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që në Strategjinë Legjislative për vitin 2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përfshihen edhe tri projektligje:
 - Projektligji për të Ardhurat Individuale
 - Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave
 - Projektligji për Normat e Akcizës në Kosovë
2. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike në Zyrën Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/31
Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Ndarjen e Dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/31
Datë: 27.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 4.000 (katërmijë) Euro, për organizimin e Ditës së të Pagjeturve.
2. Mjetet e financiare nga pika 1 e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë